



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 3915 prot.

Tiranë, më 05.04.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.837, datë 11.01.2005.

**SHOQËRISË “ALB INERT” SH.P.K  
Pranë Hotel “Freskia”, Velipojë, Shkodër.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË  
MINIERA  
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Alb Inert” sh.p.k ishte zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.837, datë 11.01.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Mali Kolaj”, Velipojë, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.432, datë 14.01.2019, “Njoftim për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur gjatë shfrytëzimit”, dërguar shoqërisë tuaj dhe për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar me nr.529/18, datë 15.01.2019, kërkohet rehabilitimi përfundimtar i sipërfaqes së shfrytëzimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.837, datë 11.01.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Mali Kolaj”, Velipojë, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëronte, pasi ka përfunduar afati i vlefshmërisë së saj.

Leja juaj ishte dhënë me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Leja nr.837, datë 11.01.2005, ka plotësuar afatin e vlefshmërisë 10 vjeçare më datë 11.01.2015, dhe bazuar në pikën 6, të nenit 24, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shoqëria juaj ka aplikuar për zgjatjen e afatit edhe për 10 vite tjera pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), aktualisht Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me numër çështje LC – 6204 – 07 - 2014.

Gjatë procedurës së shqyrtimit dhe verifikimit në GIS të aplikimit tuaj, rezulton se zona minerare për të cilën kërkohet zgjatja e afatit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.683, datë 02.11.2005, “Për Shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Liqenit të Shkodrës e të Zonës së Lumit Buna, Zonë Natyrore Veçanërisht e Mbrojtur dhe Përfshirjen në Listën e Ligatinave

me Rëndësi Ndërkombëtare, Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujore”, është shpallur zonë e mbrojtur.

Bazuar në germen “d”, të pikës nr.1, të nenit 33, “*Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak*”, të Ligjit nr.81/2017, datë 04.05.2017, “Për zonat e mbrojtura”, zhvillimi i aktivitetit minerar, brenda Zonës së Mbrojtur, lejohet të ushtrohet vetëm me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, gjë e cila për objektin në fjalë nuk është plotësuar, megjithëse u është lënë një afat i gjatë për plotësimin e kësaj kërkesë.

Leja mjedisore sipas germës “h”, të nenit 47, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është shkak ligjor, për të cilën një leje minerare revokohet.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.837, datë 11.01.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Mali Kolaj”, Velipojë, Qarku Shkodër**, që shoqëria juaj zotëronte.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.837, datë 11.01.2005, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Mali Kolaj”, Velipojë, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.432, datë 14.01.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE) me nr.529/18, datë 15.01.2019, jeni njoftuar se duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar, në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

